



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 12
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 20 maj 2015, në orën 13:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Hatim Baxhaku, Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.4.2015;
3. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për shëndetin mendor;
4. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent;
5. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri;
6. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 29.4.2015;

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 29.4.2015, pa vërejtje.

3. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për shëndetin mendor;

Flora Brovina, kryetare – Projektligji për shëndetin mendor, siç jeni në dijeni ka kaluar leximin e parë, pra është miratuar në parim në seancën e mbajtur më 18.5.2015. Ne duhet të fillojmë me shqyrtimin e tyre, fillimisht duhet të formojmë grupin e punës. Grupi i punës duhet të përgatitë planin e punës për shqyrtimin e këtij projektligji dhe po ashtu keni të drejtë nëse e vlerësoni të organizoni edhe dëgjim publik.

Pas diskutimeve kryetarja Flora Brovina, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë:

Përfundim:

Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për shëndetin mendor:

Grupi i punës ka këtë përbërje:

1. Shukrije Bytyçi, kryesuese
2. Time Kadrijaj – zëvendëskryesuese
3. Flora Brovina, anëtare
4. Njomza Emini, anëtare
5. Fikrim Damka, anëtar
6. Fadil Beka, anëtar
7. Hatim Baxhaku, anëtar
8. Besa Bafiu, anëtare

Kryetarja Flora Brovina, bëri të ditur se grupi i punës qysh në javën e ardhshme mund të fillojë me punën/takimin e tij.

Grupi i punës në bashkëpunim me stafin mbështetës të Komisionit të hartojë planin e punës dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

4. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent;

Flora Brovina, kryetare – Projektligji për shërbimin mjekësor emergjent, siç jeni në dijeni edhe ky ka kaluar leximin parë, pra është miratuar në parim në seancën e mbajtur më 18.5.2015, prandaj edhe në këtë rast ne duhet të fillojmë me shqyrtimin e tij. Fillimisht duhet të formojmë grupin e punës, pas kësaj grupi i punës duhet të përgatitë planin e punës për shqyrtimin e këtij projektligji, po ashtu keni të drejtë nëse e vlerësoni, mund të organizoni edhe dëgjim publik.

Pas diskutimeve, **Flora Brovina** konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë:

Përfundim:

Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent:

Grupi i punës ka këtë përbërje:

1. Hatim Baxhaku, kryesues
2. Fadil Beka, zëvendëskryesues
3. Flora Brovina, anëtare
4. Njomza Emini, anëtare
5. Fikrim Damka, anëtar
6. Besa Bafiu, anëtare
7. Time Kadrijaj, anëtare
8. Shukrije Bytyçi, anëtare

Flora Brovina tha se grupi i punës, qysh në javën e ardhshme mund të fillojë me punën/takimin e tij.

Grupi i punës në bashkëpunim me stafin mbështetës të Komisionit të hartojë planin e punës dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

5. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri;

Flora Brovina, kryetare – Pra edhe Projektligji për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri ka kaluar leximin parë dhe është miratuar në parim në seancën e mbajtur më 18.5.2015. Duhet të fillojmë me shqyrtimin e këtij projektligji. Fillimisht duhet të formojmë grupin e punës, e pastaj ky grup i punës duhet të përgatitë planin e punës për shqyrtimin e këtij projektligji dhe po ashtu, edhe për këtë projektligj, nëse e vlerësoni mund të organizoni dëgjim publik.

Pas diskutimeve, kryetarja **Flora Brovina**, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë:

Përfundim:

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri:

Grupi i punës ka këtë përbërje:

1. Besa Bafiu, kryesuese
2. Flora Brovina, zëvendëskryesuese
3. Njomza Emini, anëtare
4. Fikrim Damka, anëtar
5. Fadil Beka, anëtar
6. Hatim Baxhaku, anëtar
7. Time Kadrijaj, anëtare

8. Shukrije Bytyçi, anëtare

Kryetarja Flora Brovina, tha se grupi i punës qysh në javën e ardhshme mund të fillojë me punën/takimin e tij.

Grupi punues në bashkëpunim me stafin mbështetës të Komisionit të hartojë planin e punës dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

6. Të ndryshme.

Flora Brovina, kryetare, i njoftoi se në emër të komisionit kanë arritur disa kërkesa që kanë të bëjnë me Ligjin Nr. 04/L-131, për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Pas diskutimeve **kryetarja** konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë:

Përfundim:

Në mbledhjen e radhës së komisionit, të ftohet ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi, me ç'rast do të diskutohet për zbatimin e Ligjit Nr. 04/L-131, për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA